



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.8, datë 08.11.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SHOQËRISË “ACHELO” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit uJOR, e lejes/autorizimit për përdorim burimi uJOR, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit uJOR, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit UJOR Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi uJOR sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Achelo”, me adresë Njësia Administrative Pishaj Gramsh Qarku Elbasan sipas Miratimit Paraprak me Nr.525/2 , datë 15.01.2019 “Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Kotorri”, në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”, si dhe shtyrjes së afatit të Miratimit Paraprak për Hec “Kotorri” me nr.4193/1 prot., datë 8.6.2022 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për shoqërinë “Achelo” .
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:  
**HEC Kotorri**
  - Prodhimi vjetor i parashikuar: 4.780.000 kwh/vit
  - Fuqia e instaluar: 1.900 kwh
  - Vlera totale e investimit: 230,573,228 lekë me TVSH.

### Vendndodhja e veprës së marrjes/ burimi ujq Përroi i Seltës

- X= 517527; Y= 4532965; Z=245 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 3.7 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 1.51 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.27 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.1 m<sup>3</sup>/s

### Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 514082; Y= 4532125; Z=178 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 3.7 m<sup>3</sup>/s

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

